

Pseudos dhe Aletheia

arbanika.com

Këto dy fjalë vinë prej greqishtes së lashtë; ψευδής pseudés ‘rrenë’; ἀληθής alēthés ‘e vërtetë’. Por, ato nuk duhen kuptua si në konceptet e mavonëshme të ndikuome prej shkencës e fésë, si fallso/e vërtetë. Æsht mã e arsyeshme me e kuptua ‘pseudo’ si pseudo-e-vërtetë, ose e vërtetë popullore, p.sh. pëlqimet në mediat shoqnore, dhe ‘aletheia’ si një e vërtetë që kërkon përpjekje e mundime serioze me u zbulua.

Në librin e tij “Theogonia”, Hesiodi quan ‘pseudos’ kangët popullore të kënduome rapsodësh të ndryshëm, caku i të cilëve ishte me argëtua masat. ‘Aletheia’ ai quan kangët e tij, të cilat atij ia mësuan Muzat; të bijat e Zeusit, të cilat ishin edhe Zoteshat e historisë. Në kontekstin e botës së sotëme, pseudos përkon me popullaritetin në rrjetë, kurse alétheia përkon me kërkimet serioze të bame prej personash a institucionesh profesioniste.

Koncepti i aletheias mund të merret si “përpjekje e dijes me iu fshehë njeriut” sepse jeta është e ndërtuome në atë mënyrë që dija autentike i shmanget njeriut, i rrëshqet njeriut para sysh; disi e maskuome. Për shembull, njeriu mund të harrojë diçka, atij mund t’i nguliten në mendje koncepte të pavërteta, popullariteti mund t’ia zëvendsojë atij dijen me pseudo-dije, shoqnia ose qeveria mund të ndalojë diskursin e koncepteve kontroversiale, e të tjera. Heideger e ndan fjalën aletheia sipas etimologjisë a=jo dhe lethe=e harruome. Këtë ai e lidhë me kalimin e të vdekunve në Greqinë e lashtë nëpër lumin e harresës Lethe.

Pseudo-dija, ku njeriu, si makinë kujtese, regjistron fakte, mund t’i ndihmojë individit me ndërtua njëfarë inventari faktesh, por jo me zhvillua kulturë përsonale. Përspektazi me këtë përmendëshsim, dija e përfthuome prej landëve të triviumit e ndihmon njeriun me qenë i vetdijëshëm rreth nevojës me përmirsua njohunitë autentike rreth vetvetes, shoqnisë, botës, dhe kozmosit.